



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 28 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për parashtrime lidhur me sistemin e redaktimit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bóné

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 23(1) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 80 dhe 108(1) dhe (5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* së bashku me materialin provues në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.²

2. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi "Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës" ("Vendim për konfirmimin"),³ "Fletarrestim për z. Salih Mustafa"⁴ dhe "Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara".⁵

3. Më 19 qershor 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi aktakuzën e konfirmuar.⁶

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat në lidhje me të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Version i redaktuar publik i fletarrestimit për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00009/A02/RED, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Version i redaktuar publik i urdhrimit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 qershor 2020, publik.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së konfirmuar*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së konfirmuar u protokollua më 28 shtator 2020 (KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojcë 1 e Parashtrimit të versionit të redaktuar më tej të Aktakuzës së konfirmuar*, 28 shtator 2020, publik).

4. Më 24 shtator 2020, Salih Mustafa (“z. Mustafa” ose “i akuzuari”) u arrestua⁷ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁸

5. Më 28 shtator 2020, Administratorja caktoi me kusht Julius von Bóné si mbrojtës të z. Mustafa.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në pajtim me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores, një trup gjykues mund të urdhërojë masa të duhura për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në proceset gjyqësore si dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmime të dhëna nga dëshmitarët.

7. Në pajtim me rregullën 80(4)(a)(i) dhe (d) të Rregullores, ndër masa të tilla mund të jenë redaktimi i emrave dhe të dhënave të tjera identifikuese për parandalimin e nxjerrjes së këtyre të dhënave për publikun dhe/ose të akuzuarin, kur e nevojshme, të identitetit dhe/ose vendndodhjes së dëshmitarit, viktimës pjesëmarrëse në procesin gjyqësor apo të një personi të familjes ose që ka lidhje me ata.

8. Në pajtim me rregullën 108(1) të Rregullores, Prokurori i Specializuar mund t’i bëjë kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* trupit gjykues për mosnxjerrjen e informacioneve në tërësi ose pjesërisht të cilat, ndër të tjera mund të dëmtojnë hetimet në kryerje e sipër ose hetimet e ardhshme. E njëjta është e zbatueshme *mutatis mutandis* edhe për Mbrojtjen.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00014, Administratorja, *Njoftimi i pranimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2020-05, F00020, Administratorja, *Njoftim mbi caktimin me kusht të mbrojtësit*, 28 shtator 2020, publik, me një shtojcë, konfidenciale.

III. DISKUTIM

9. Duke mbajtur parasysh arrestimin dhe transferimin e Z. Mustafa, pritet që procesi i nxjerrjes së provave për të akuzuarin nga Prokurori i Specializuar të fillojë pa vonesë, në pajtim me Rregulloren. Rrjedhimisht, është e nevojshme të kërkohen parashtrimet e palëve lidhur me redaktimin e informacioneve dhe provave. Parashtrimet e tyre do t'i shërbejnë gjykatësit të procedurës paraprake në miratimin e sistemit të redaktimit i cili do të sigurojë efikasitet të procesit të nxjerrjes së informacionit duke vendosur një një baraspeshë midis detyrës për mbrojtjen e interesave të caktuara e nga ana tjetër duke respektuar të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21 të Ligjit.

IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **KËRKON** nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të parashtojë vërejtjet e veta në përputhje me paragrafin 9 të këtij urdhri deri **të enjten, më 1 tetor 2020**; dhe
- b. **KËRKON** nga Mbrojtja të parashtojë vërejtjet e veta në përputhje me paragrafin 9 të këtij urdhrit deri **të hënë, më 5 tetor 2020**.

/nënshkrim/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i procedurës paraprake

Data: e hënë, 28 shtator 2020
në Hagë, Holandë.